

Hapet thirrja për bursa studimi në Universitetin e Masaryk, në Çeki, në kuadër të programit Erasmus +

A jeni të interesuar për të përfituar një bursë studimi në programin prestigjioz Erasmus + të Komisionit Evropian? A jeni gati për një super eksperiencë studimi ndërkombëtare? Ky është shansi Juaj. Universiteti Metropolitan Tirana u ofron mundësinë studentëve të tij të aplikojnë për bursa studimi një semestrale në Universitetin e Masaryk, në Çeki.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e parë ose të dytë të vitit akademik 2020-2021 në Universitetin e Masaryk.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT në Fakultetin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe IT, si edhe studentët në Fakultetin e Ekonomisë:

- Viti i I, viti II, bachelor;
- Viti i I, master.

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Aplikimi realizohet online nga vetë studenti aplikues. Për më shumë informacion mbi procedurën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm vizitoni: <https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/exchange-non-degree-studies/erasmus-icm#application-process>

Një prej dokumentave të nevojshëm është Learning Agreement. Vini re:

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Masaryk lëndë të ngjashme me ato që do të kryenit në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillojnë në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillojnë lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Për më shumë informacion mbi dokumentin e Learning Agreement klikoni në adresën: <https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/exchange-non-degree-studies/erasmus-icm#learning-agreement>

Për më shumë informacion mbi programin e studimit të ofruar nga Universiteti i Masaryk vizitoni <https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/international-student-guide/course-catalogue>

Për më shumë informacion mbi thirrjen për bursë Erasmus vizitoni:
<https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/exchange-non-degree-studies/erasmus-icm> ose na kontaktoni në adresën eelmazi@umt.edu.al

Afati për aplikimin online: **15 Mars 2020**

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!